



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.03.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik Gëzime S. Gashi B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru për ngrohje", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1707-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-019-121, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Gëzime S. Gashi B.I., e dt.13.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru për ngrohje", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1707-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-019-121, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 01.03.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 01.03.2024;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Gëzime S. Gashi B.I., me dt.13.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru për ngrohje", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1707-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-019-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, kerkesen e vendosur ne Dosjen e Tenderit qe Operoret Ekonomik te jene te Licensuar, e ka bere konforme:

LIGJI NR.08/L-137 PËR PYJET


1.27. Subjektet e licencuara - janë çdo institucion, ndërmarrje, kompani ose person fizik, që janë licencuar nga Ministria, të aftë për të ushtruar aktivitete të caktuara që parashihen me këtë ligj;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;